

VENDIM
Nr. 903, datë 17.12.2014

PËR KRIJIMIN E ARKIVIT SHETETËROR TË SISTEMIT GJYQËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të neneve 20, pika 4, e 21, pika 2, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat" dhe të nenit 6, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pranë Ministrisë së Drejtësisë të krijohet Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, me seli në Tiranë.
 2. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor ka për mision ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit gjyqësor, i cili i nënshtrohet procedurës së arkivimit nga gjykatat.
 3. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor kujdeset për menaxhimin e arkivave të gjykatave nëpërmjet aplikimit të teknikave të unifikuara për krijimin, përdorimin, mirëmbajtjen, ruajtjen, transferimin dhe asgjësimin e dosjeve, regjistrave dhe dokumenteve të tjera gjyqësore si dhe sigurimin e aksesit për të interesuarit.
 4. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor mban dhe përditëson regjistrin, në formë shkresore dhe elektronike, të të dhënave mbi dokumentacionin gjyqësor që i nënshtrohet procedurave të përpunimit dhe administrimit. Formatit dhe përmbajtja e regjistrit përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.
 5. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor ka të drejtë të kërkojë dhe të verifikojë, nga kancelarët e gjykatave, zbatimin e njëzuar të shërbimit arkivor gjyqësor, si dhe çdo informacion, të cilin e konsideron të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të ngarkuara.
 6. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, për zbatimin e metodologjisë profesionale, rregullave dhe kërkesave të ligjit për arkivat.
 7. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili i raporton ministrit të Drejtësisë.
 8. Drejtori i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - a) Drejton veprimtarinë e përditshme të institucionit;
 - b) Përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët;
 - c) Bashkëpunon me gjykatat për realizimin e procedurave për transferimin dhe asgjësimin e dosjeve gjyqësore, në përputhje me kriteret dhe rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat;
 - ç) I propozon për miratim ministrit të Drejtësisë rregulloren e brendshme organizative të institucionit dhe çdo akt tjetër normativ të nevojshëm për caktimin e rregullave për administrimin e dosjeve gjyqësore;
 - d) Miraton rregullat tekniko-profesionale, metodikën dhe tipologjinë e unifikuar për shërbimin arkivor gjyqësor;
 - dh) Kryen detyra të tjera, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për arkivat dhe për organizimin e funksionimin e administratës shtetërore.
 9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.
 10. Ngarkohen ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama